

E vërteta kushtetuese

[Botuar në Gazeta Shqiptare, më 31.7.05, *është hequr paragrafi i parafundit.*]

Zgjedhjet po mbarojnë, tashmë do të kemi Kuvendin e ri, ku shumica e deputetëve, së paku 73 nga 140, duket se do të jenë të koalicionit të kryesuar nga berishizmi. Kuvendi do të jetë i “ligjshëm”, dhe i “çertifikuar”. Së shpejti do të kemi edhe një qeveri me z. Berisha kryeministër, dhe edhe ajo e ligjshme dhe e çertifikuar. Por megjithatë, ky Kuvend do të jetë në fakt, në kundërshtim me ligjin bazë të Shqipërisë, në kundërshtim me Kushtetutën tonë.

Në tabelën 1, përbri, kemi llogaritur disa raporte, sa për të pasur një vështrim paraprak për rezultatet e zgjedhjeve tona “megadushk”.

Tabela 1

Porte

Votues të regjistruar në listat	2.8	in milionë
Votues që morën pjesë në votime	1.6	in milionë
Pjesëmarrja në votime	57%	
Raporti i votave të PD dhe aleatëve të saj, me votat e llogaritura me gjithë	42%	
Raporti i votave të PS dhe aleatëve të saj, me votat e llogaritura me gjithë	39%	
Raporti i votave të LSI dhe aleatëve të saj, me votat e llogaritura me gjithë	8%	
Raporti i votave të PD dhe aleatëve të saj, me numrin e votuesve	24%	
Raporti i votave të PS dhe aleatëve të saj, me numrin e votuesve	22%	
Raporti i votave të LSI dhe aleatëve të saj, me numrin e votuesve	5%	
Raporti i votave për LSI, me votat për PD dhe aleatët e saj	20%	
Raporti i votave për LSI, me votat për PS dhe aleatët e saj	22%	

Shpresojme që e vërteta e thënë troç, të inatosë sa më pak lexues.

Siç shihet, pak arsye ka që “fitimtari”, berishizmi, të fryhet, ndër kohë që ka mjaft arsye që shumica e shqiptarëve edhe të gëzohen dhe njëkohësisht edhe të pikëllohen. Gëzohen njerëzit sepse po ikin ata “të korruptuarit e PS-së”, dhe pikëllohen për atë që po vjen! Për berishizmin dhe të tijtë, kanë votuar vetëm 24% e shqiptarëve me të drejtë vote. Ç’është dhe më absurdja, janë 58% e shqiptarëve që votuan, që e kanë dhënë votën e tyre kundër, ose e thënë “amerikanshe”, si po e ka qejfë kohët e fundit lideri z. Berisha, kanë votuar 58 vetë kundër tij, në çdo çdo 100 vetë që votuan. E imagjinojeni, Ai ka “humbur” prap, edhe pas 8 vjetëve opozitë, kur kundërshtari i tij, nanoizmi, pat vendosur një nga rregjimet e “çertifikuar” si më të degjeneruarin në botë; ka humbur prap, me gjithë se bëri çmos që të mbetet i vetëm në opozitë duke shkatërruar çdo forcë tjetër opozitare, duke krijuar një shkretëtirë politike, që të mos u linte mundësi tjetër votuesve, veç se të votonin për të “si e keqja më e vogël”; ka humbur prap, me gjithë se u bleu votën, me premtimin për t’u falur tokën tonë, atyre që e kanë pushtuar! Në këto kushte, çdo politikan normal në botë, do të jepte dorëheqje si kryeministër, duke i lënë kolegët e tij të qeverisnin. Njerëzit mezi po presin të iki edhe Ai tjetri, z. Nano. Ju kujtojmë se “Nano ik”, kanë votuar mbi 50% e votuesve (PD dhe aleatët e saj, dhe LSI). Por jo, nuk jemi normalë, z.

Berisha prap na e hodhi: Atë do ta kemi prap kryeministër me gjithëse për të votoi kundër shumica e shqiptarëve që votuan (ai ishte kryeministri faktik edhe i vitit 1996-97)!

Po a mos jemi para një kontradikte në mes Kodit zgjedhor dhe Kushtetutës, dhe nuk kishte asnjë zgjidhje për të zhdukur këtë kontradiktë?

Natyrisht që ka një kontradiktë në mes Kodit zgjedhor dhe Kushtetutës, por mendojmë se një vullnet i zbatimit të Kushtetutës do të bënte të mundur eliminimin e shkeljes së Kushtetutës, së paku në këto zgjedhje. Në nenin 64, paragrafi 2, të Kushtetutës, shkruhet: “Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve”. Kjo kërkesë nuk është respektuar në vlerësimin e votimeve të kryera.

Zgjidhja kushtetuese do duhej të bazohet në pranimin e faktit të njohur nga kushdo, edhe nga më tifozët (militantët), se qoftë PS-ja me partitë e saj në koalicion parazgjedhor, dhe poashtu edhe PD-ja me partitë e saj në koalicion parazgjedhor, u sollën dhe vepruan krejtësisht si koalicione. E mbasi është pranuar ky fakt, vjen kërkesa normale që edhe në vlerësimin e votave të respektohej fakti, dhe të pranoheshin këto koalicione. Në se do të pranoheshin gjërat e vërteta ashqare, duhet t’u mblidheshin në një vend votat e të gjithë partive të koalicioneve, qoftë atij socialist, e qoftë atij demokrat. Rezultati do të ishte krejt në përputhje me Kushtetutë, siç jepet në kolonën “Kushtetuta” në tabelën 2, përbri. Brenda koalicioneve, aleatët do të ndanin votat e tyre në proporcion me rezultatin që kanë dashur vetë të regjistrojnë. Sidoqoftë, ajo që është e pamundur të bëhet me ligjet e këtij farë shteti, e të këtij lloj civilizimi, nuk do të thotë se nuk është e mundur të bëhet moralisht, me mendjen dhe zemrat e asaj pjese të shqiptarëve, që e kanë forcën t’u shmangen pasioneve të momentit, dhe të shohin të vërtetat në sy: PD-së dhe aleatëve të saj, do t’i duhesh një koalicion me LSI-në për të formuar një qeveri të votuar “nga jo më pak se gjysma e votuesve”. Ky koalicion do të ishte krejt i mundshëm, me kusht që z. Berisha të mos ishte kryeministër, gjë që do t’u hiqte pikëllimin shumë shqiptarëve.

Propozimi parazgjedhjeve i berishizmit (PD-së), për të shmangur kontradiktën Kod-Kushtetutë, kishte brëda shejtanllëk: synonte të linte pa votuar shumë nga antimonopolistët, ata që kësaj here votuan për heqjen nga politika të dy komplementarëve, nanoizmit dhe berishizmit. Propozimi konsistonte në lënien e zgjedhësve vetëm me një votë, nga dy që jepte Kodi: votimi për kandidatin në maxhoritar, automatikisht të ishte votim edhe në proporcional, për partinë që mbështeste kandidatin. Por, një zgjidhje e tillë, do të kishte ulur pjesëmarrjen në votime. Kjo sepse nuk do të vinin në votim antimonopolistët, me që u hiqej e drejta për të pasur dy vota, një për kandidatin, dhe një për partinë.

Në mbyllje, le t’i kthehemi edhe një herë tabelës 2. Të dhënat janë marrë në internet, në faqen e Komisionit Qëndror të zgjedhjeve (datë 28 korrik 2005; natyrisht këto të dhëna do të azhurnohen, por të pakta do të jenë ndryshimet në raportet, në përqindjet, dhe edhe në konkluzionet që nxirren prej tyre që tani). Shpresojmë që pasaktësitë të jenë të vogla, me që veprimet janë bërë në excel (program i kompjuterit që bën veprime matematike etj.). Krahasoni numrin e deputetëve sipas megadushkut (legali), me atë të deputetëve që duhet të kishim në se do të zbatohesh kushtetuta. Rezultati i këtij krahasimi jepet si shmangie (gabim) në përqindje në mes dy kolonave.

Tabela 2**Shmangiet nga Kushtetuta**

Koalicioni ose partia	Votues	%	Deputetët		
			Megadushk	Kushtetutë	Shmangia
Koalicioni i Dëshmorit aleatët	574,747	45.4%	76	63	20.6%
Koalicioni i Bashkimit aleatët	523,443	41.3%	55	58	5.2%
LS	113,404	9.0%	6	13	53.8%
BNJ	55,046	4.3%	3	6	50.0%
Gjithëj	1,266,640	100.0%	140	140	
Aleatët e PD-së					
R			12	3	300.0%
DR			4	1	300.0%
BK			2	1	100.0%
Gjithëj			18	5	260.0%
Aleatët e PS-së					
PA			3	4	25.0%
D			3	3	0.0%
B			7	8	12.5%
DS			2	3	33.3%
Gjithëj			15	18	16.7%

Besoj se çdo lexues do të bjerë dakord, se deputetët e megadushkut nuk janë fare “në raport të përafërt me votat e vlefshme”, sepse nuk mund të quhen “të përafërta” shmangiet me 50% (apo dhe 300%)!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 29.7.2005